



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-239

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR HUA DHE FINANCIM
NËPËRMJET KfW FRANKFURT AM MAIN, REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE OPERATORIT TË SISTEMIT, TRANSMISIONIT
DHE TREGUT KOSTT, PËR PËRMIRËSIMIN E RRJETIT TË
TRANSMISIONIT**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR HUA DHE
FINANCIM NËPËRMJET KfW FRANKFURT AM MAIN,
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE OPERATORIT TË SISTEMIT,
TRANSMISIONIT DHE TREGUT KOSTT, PËR PËRMIRËSIMIN E
RRJETIT TË TRANSMISIONIT**

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes për Hua dhe Financim nëpërmjet KfW Frankfurt am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSTT, për Përmirësimin e Rrjetit të Transmisionit.

2. Nëpërmjet këtij ligjit ratifikohet marrëveshja financiare e lartcekur e cila siguron njëzet e tre milion e pesqindmijë euro (23.500.000 €), e përbërë nga huaja dhe kontributi financiar, shumë e cila do t'i sigurohet Agjencionit për Ekzekutimin e Projektit (KOSTT) për realizimin e Projektit të Përmirësimit të Rrjetit dhe Transmisionit, sipas kushteve të parapara në marrëveshje.

Neni 2
Ratifikimi i marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja për Hua dhe Financim nëpërmjet KfW Frankfurt am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSTT, për Përmirësimin e Rrjetit të Transmisionit, e lidhur më 23 shtator 2013 në Prishtinë.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

1. Në Aneksin 1 të këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshjen për Hua dhe Financim nëpërmjet KfW Frankfurt am Main, Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSTT, për Përmirësimin e Rrjetit të Transmisionit, e nënshkruar më 23 shtator 2013, në Prishtinë.

2. Në Aneksin 2 të këtij ligji është e bashkëngjitur Marrëveshja e Nën-huazimi në mes të Republikës së Kosovës dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut KOSTT, për Përmirësimin e Rrjetit të Transmisionit, e nënshkruar më 7 tetor 2013, në Prishtinë.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-239
31 janar 2014

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI

Marrëveshje për hua dhe financim

e datës

ndërmjet

KfW Frankfurt am Main

(“KfW”)

dhe

Republikës së Kosovës

të përfaqësuar nga

Ministria e Financave

(“Huamarrësi”)

dhe

Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a.

KOSTT, Prishtinë

(“Agjencia për Ekzekutimin e Projektit”)

për EUR 23,500,000

- Përmirësimi i rrjetit të transmisionit

(Programi i sektorit të energjisë, faza IV dhe V)

(BMZ ID 2011.65.604, 2012.66.097)

Përmbajtja

1. Shuma dhe Qëllimi i Huasë dhe Kontributit Financiar
2. Drejtimi i Huasë për Agjencia për Ekzekutimin e Projektit
3. Disbursimi
4. Taksat
5. Interesi
6. Rikthimi dhe Parapagimi
7. Kalkulimet dhe pagesat në përgjithësi
8. Garancioni negativ dhe *Pari Passu* dhe Sigurimi
9. Kostot dhe pagesat publike
10. Obligimet speciale
11. Arsyet për anulimin e huasë dhe suspendimi i Kontributit Financiar
12. Përfaqësimi dhe deklaratat
13. Dispozitat e përgjithshme

Aneksi 1 Mostra e Konfirmimit të gatishmërisë për operim

Aneksi 2 Mostra e Mendimit ligjor

Preambula

Baza për këtë Marrëveshje për hua dhe financim ("**Marrëveshja**") është Përmbledhja e Procesverbalit të Negociatave për Bashkëpunimin zhvillimor të datës 30 shtator 2011 dhe 21 shtator 2012 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës ("**Marrëveshja Qeveritare**").

Arsyeja për lidhjen e kësaj marrëveshje është **Përmirësimi i rrjetit të transmisionit ("Projekti")** i planifikuar nga Huamarrësi dhe Agjencia për Ekzekutimin e Projektit.

Projektit mund ti alokohet financim shtesë në shumën prej 7,350.000 Euro nga fondet e Bashkimit Evropian. Subjekt i, *inter alia*, arritjes së marrëveshjeve respektive ndërmjet KfW dhe Bashkimit Evropian, KfW do të hyjë në marrëveshje për financim me Huamarrësin me qëllim që Projektit ti ofrohen fondet e Bashkimit Evropian.

Me kusht që një pjesë e kërkesave të KfW, që lindin nga kjo Marrëveshje, të mbulohen nga një apo më shumë polica të sigurimit të investimit të kënaqshme për KfW (në tekstin e mëtejshëm i referohet si "**Sigurimi i Investimit**"), KfW e konfirmon gatishmërinë e saj që pjesërisht ta financoj Projektin në pajtim me dispozitat vijuese.

1. Shuma dhe qëllimi i Huasë dhe Kontributit financiar

1.1 *Shuma*. KfW do t'i jep Huamarrësit një Kontribut financiar dhe një Hua jo më shumë se

23,500,000 Euro

që përbëhet nga Kontributi financiar në shumë prej

3,000,000 Euro ("**Kontributi Financiar**")

dhe një huaje prej

20,500,000 Euro ("**Hua**")

Në një Pjesë I prej

5,000,000 Euro ("**Pjesa I**")

Në një Pjesë II prej

15,500.000 Euro (“**Pjesa II**”)

Kontributi financiar nuk do të jetë i kthyeshëm përderisa të kushtëzohet ndryshe në nenin 11.5.

1.2 *Qëllimi.* Huamarrësi do ta drejtojë Kontributin financiar dhe Huanë në tërësi tek Agjencia për Ekzekutimin e Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenin 2. Agjencia për Ekzekutimin e Projektit do ta përdor Kontributin financiar dhe Huanë ekskluzivisht për të paguar shpenzimet në lidhje me Projektin (“**Shpenzimet e Projektit**”), dhe në rend të parë të financojë shpenzimet e shkëmbimit të huaj valutor.

Ne veçanti, Pjesa II e Huasë do të përdoret ekskluzivisht për të financuar shërbimet dhe mallrat të ofruara në bazë të një kontrate për sigurimin e investimit apo kontrata të ndryshme për sigurimin e investimit që do të tenderohen në të ardhmen (në tekstin e mëtejme i referohet si “**Kontrata Eksporti**”) dhe financimi i të cilave do të mbulohet nga Sigurimi i investimit, i pranueshëm nga KfW.

Përmes një marrëveshje të veçantë, Agjencia për Ekzekutimin e Projektit dhe KfW do të përcaktojnë detalet e projektit, shpenzimet e projektit që do të financohen nga Kontributi Financiar dhe Huaja, kushtet e ndërlidhura me Sigurimin e investimit si dhe Kontrata e sigurimit, dhe nëse është e aplikueshme, përgjegjësitë që rezultojnë nga kushtet e Sigurimit të investimit.

1.3 *Taksat, shpenzimet, obligimet doganore.* Taksat dhe pagesat tjera publike që do të mbulohen nga Huamarrësi apo Agjencia për Ekzekutimin e Projektit dhe po ashtu ngarkesat doganore, nuk do të financohen nga Kontributi Financiar dhe Huaja.

2. Drejtimi i Kontributit Financiar dhe Huasë tek Agjencia për Ekzekutimin e Projektit

2.1 *Marrëveshja e nën-huazimit.* Huamarrësi do ta drejtojë Kontributin Financiar dhe Huan tek Agjencia për Ekzekutimin e Projektit (AEP) me një marrëveshje të veçantë të nën-huazimit (“Marrëveshja e Nën-huazimit”) që do të lidhet ndërmjet Huamarrësit dhe AEP-ja sipas kushteve të përcaktuara në Nenet 4,5, dhe 6 këtu.

2.2 Huamarrësi do ta drejtojë Kontributin financiar tek Agjencia për Ekzekutimin e Projektit sipas një marrëveshje të veçantë për huazim me një normë vjetore interesi prej 0.75% dhe për një periudhë prej 40 viteve duke përfshirë edhe periudhën grejs prej 10 viteve, duke filluar nga 1 janar 2014.

2.3 *Përkthimi i certifikuar.* Para disbursimit të parë të Kontributit Financiar dhe Huasë, Huamarrësi do t’ia dërgoj KfW një përkthim të certifikuar të Marrëveshjes së Huazimit të specifikuar në nenin 2.1 si dhe marrëveshjes së veçantë të specifikuar në nenin 2.2.

2.4 Detyrimi i përbashkët dhe individual. Agjencia për Ekzekutimin e Projektit dhe Huamarrësi, së bashku dhe secilin individualisht, do të jenë përgjegjës para KfW për çdo obligim pagese dhe obligime të tjera të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje.

3. Disbursimi

3.1 *Kërkesa për disbursim.* Menjëherë pas plotësimit të gjitha parakushteve për disbursim sipas Nenit 3.5, KfW do të disbursoj si vijon:

- a) Kontributin Financiar dhe Pjesën I në përputhje me progresin e projektit dhe sipas kërkesës së Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit;
- b) Pjesën II në përputhje me ofrimin e furnizimeve dhe shërbimeve të dakorduara me Kontratën e sigurimit të siguruar me një Marrëveshje për sigurimin e investimit.

3.2 *Marrëveshja e veçantë.* Në një marrëveshje të veçantë, Agjencia për Ekzekutimin e Projektit dhe KfW do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, veçanërisht dëshmitë që duhet të dorëzohen nga Agjencia për Ekzekutimin e Projektit që vërtetojnë se Kontributi Financiar i kërkuar dhe shumat e Huasë janë përdorur për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

3.3 *Reduktimi i kostos së projektit.* Në rast se kostoja e projektit reduktohet, zbatim do të gjejnë këto:

- a) Nëse çmimi i përgjithshëm i mallrave dhe shërbimeve që do të ofrohen me Kontratën e eksportit dhe që do të financohen nga Kontributi Financiar dhe Huaja zvogëlohet gjatë periudhës së disbursimit, KfW do ta zvogëlojë Kontributin Financiar dhe Huanë *pro rata*. Nëse çmimi i përgjithshëm i pajtuar në Kontratën e Eksportit zvogëlohet dhe nëse Kontributi Financiar ose Huaja është disbursuar tërësisht, KfW mund ti ndryshoj transferet në libra në mënyrë që ta ri-themeloj raportin fillestar ndërmjet Kontributit Financiar dhe Huasë siç është përcaktuar në Nenin 1.1.
- b) Nëse çmimi i përgjithshëm i mallrave dhe shërbimeve që do të ofrohen me Kontratën e Eksportit dhe që do të financohen nga Kontributi Financiar dhe Huaja zvogëlohet pas disbursimit të plotë të Huasë dhe, siç mund të jetë rasti, të disbursimit të plotë të asaj pjese të Kontributit Financiar të dedikuar për financimin e mallrave dhe shërbimeve sipas Kontratës për Eksport, Huamarrësi do ti shlyej KfW pa vonesë, në kohën kur KfW kërkon, atë përqindje të shumës për të cilën çmimi i përgjithshëm i mallrave dhe shërbimeve të financuar nga Huaja është zvogëluar që korrespondon me përqindjen e financimit të dhënë nga KfW për mallrat dhe shërbimet sipas Kontratës së Eksportit. Shuma e shlyer do të kompensohet në regjistrat e Huasë dhe Kontributit Financiar në përputhshmëri me përqindjen fillestare të Huasë, dhe si mund të jetë rasti, asaj pjese të Kontributit Financiar të alokuar për financimin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara sipas Kontratës së Eksportit. Rrjedhimisht, për aq sa pagesat janë kompensuar kundrejt Huasë, Huamarrësi do të paguajë kompensim për parapagim siç është përcaktuar në detaje në Nenin 6.5 (f) këtu.

3.4 *Afat për kërkim të disbursimit.* KfW mund ta refuzojë disbursimin pas 31 dhjetorit, 2016. Nëse ekzekutimi i Kontratës së Eksportit vonohet, KfW do ta ekzaminojë nëse dhe nën çfarë kushte ky afat mund të zgjatet.

3.5 *Kushtet para disbursimit.* KfW është e obliguar ta bëjë disbursimin e çfarëdo shume sipas kësaj Marrëveshje vetëm pas përmbushjes së kushteve paraprake të paraqitura në vijim:

- a) Huamarrësi e ka furnizuar KfW me dëshmi të kënaqshme për KfW që provojnë se Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas ligjit të tij kushtetues dhe dispozitave tjera ligjore për marrjen valide përsipër të të gjitha obligimeve të veta sipas kësaj Marrëveshje duke prezantuar një opinion ligjor në formën dhe përmbajtjen si ajo në Aneksin 2 dhe duke

- prezantuar kopje të certifikuara (secila me përkthim në gjermanisht apo anglisht) të të gjitha dokumenteve të cilave iu referohet ky mendim ligjor;
- b) pranimi të mostrave të nënshkrimeve të referuara në Nenin 12.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit dhe Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit);
 - c) pranimi të një origjinali të ekzekutuar siç duhet të kësaj Marrëveshje;
 - d) dëshmi të kënaqshme për KfW që kjo Marrëveshje është ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës;
 - e) në rastin se disbursimi bëhet nga Pjesa II e Huasë, Sigurimi i investimit për të gjitha kërkesat e KfW sipas kësaj Huaje është në fuqi dhe efekt pa ndonjë kufizim;
 - d) huamarrësi ka paguar taksën e menaxhimit të përmendur në Nenin 4.2;
 - e) nuk ka ngjarë asnjë arsye për anulim /ngjarje e shkeljes;
 - f) KfW i janë dorëzuar dokumentet e Sigurisë të referuara në Nenin 8.3 dhe 8.4 i në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për KfW;
 - g) Agjencia për Ekzekutimin e Projektit ka përmbushur obligimet e veta të përcaktuara në Nenet 8.3 dhe 8.4 përfshirë, pa kufizim, obligimin e vet për të kredituar disa shuma përkatëse në Llogarinë e Depozitimit të parasë së gatshme.
 - h) një opinion ligjor (i pranueshëm për KfW) i një këshilltari ligjor (të pranueshëm për KfW) për Agjencinë për Ekzekutimin e Projektit i cili ofron Siguri, i është ofruar KfW, i shoqëruar me dokumentet e tilla që KfW mundet arsyeshëm t'i kërkoj;
 - i) nuk janë paraqitur kushte të jashtëzakonshme të cilat pengojnë apo rrezikojnë seriozisht implementimin, operimin, apo qëllimin e Projektit, ose kryerjen e obligimeve për pagesë të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshje; dhe
 - j) pranimi të dëshmimeve të nevojshme sipas Nenit 9.4 (Përfshirja nga Tatimi).

KfW ka të drejtë të kërkoj dokumente dhe dëshmi shtesë nëse mendon se është e arsyeshme para çfarëdo disbursimi nga Huaja.

3.6 *Heqja dorë nga disbursimi.* Huamarrësi mund të

- a) mos pranoj disbursimin e shumave të pa disbursuara të Kontributit Financiar apo Pjesës I të Huasë me kusht që Huamarrësi i ka plotësuar obligimet sipas Nenit 10; dhe
- b) mos pranoj disbursimin e shumave të Pjesës II të Huasë vetëm me pëlqimin e KfW dhe vetëm kundrejt pagesës së kompensimit të mos-pranimi sipas Nenit 3.7.

3.7 *Kompensimi i mos-pranimi*. Nëse Huamarrësi e heq dorë nga disbursimi i një shume nga Pjesa II e Huasë për të cilën tashmë është përcaktuar norma e interesit apo nëse një shumë e tillë e Huasë nuk është disbursuar fare apo nuk është disbursuar brenda afatit të caktuar në Nenin 3.4 për arsye tjera për të cilat KfW nuk mund të mbahet përgjegjëse, Huamarrësi shpejt do të paguajë KfW me kërkesë të saj atë shumë që kërkohet për ta kompensuar KfW për çfarëdo humbje, shpenzime apo kosto të ndodhura nga KfW si rezultat i mos-pranimi të shumës përkatëse të Huasë. KfW do ta kalkulojë kompensimin e mos-pranimi dhe do t'ia komunikojë atë Huamarrësit.

4. Taksat

4.1 *Taksa e angazhimit*. Huamarrësi do ta paguajë një taksë vjetore të pakthyeshme të angazhimit prej 0.25% mbi shumën e pa disbursuar të Huasë. Taksa e angazhimit do të paguhet tre muaj pasi kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi dhe do të paguhet deri në datën e disbursimit të plotë të Huasë. Do të jetë e pagueshme në këste gjysmë-vjetore në datat e specifikuar më poshtë (secila një **“Datë Pagese”**):

- a) para datës së caktuar të shlyerjes së kështit të parë të Pjesës I dhe II të Huasë, me 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti; për herë të parë me 30 dhjetor 2013;
- b) në datën e shlyerjes të kështit të parë të Pjesës I dhe II të Huasë, bashkë me kështin e tillë;
- c) mëpastaj, në datat e mëvonshme të caktuara për shlyerje të kësteve të Pjesës I dhe II sipas Nenit 6.2.

4.2 *Taksa e menaxhimit*. Huamarrësi do të paguajë KfW një taksë paushallë pakthyeshme të menaxhimit të prej 1.0% të shumës së kryegjësë së Pjesës II të Huasë të cekur në Nenin 1.1 (d.m.th. për ti mënjeluar dyshimet, një shumë prej 155,000.00 Euro) dhe më së voni me kalimin e periudhës tre-mujore pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, por në çdo rast para disbursimit të parë nga Huaja.

5. Interesi

5.1 *Kontributi Financiar*. Huamarrësi nuk do të paguajë interes për Kontributin Financiar.

5.2 *Interesi mbi Huanë (norma fikse e interesit e përcaktuar pas zotimit të Huasë)*.

- a) *Shkalla e interesit për Pjesën I*. Huamarrësi do të paguajë interes për Pjesën I me një normë vjetore prej ...%
- b) *Shkalla e interesit për Pjesën II*. Huamarrësi do të paguajë interes për Pjesën II me një normë vjetore prej ...%, në pajtim me dispozitat e mëposhtme.
- c) *Njoftimi i normës së interesit*. Huamarrësi do ta njoftojë menjëherë KfW pasi Marrëveshja të jetë ratifikuar nga Parlamenti i Kosovës dhe ratifikimi të jetë publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës siç përcaktohet në Nenin 13.11. Pesë ditë bankare pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe efekt sipas Nenit 13.11, KfW do ta përcaktojë normën e interesit e cila do të aplikohet deri në shlyerjen e kështit të fundit sipas Nenit 6.3 dhe për këtë do ta njoftojë Huamarrësin.

5.3 *Kalkulimi i interesit dhe datat për pagimin e interesit.*

- a) *Kontributi Financiar*: Për Kontributin Financiar nuk do të paguhet interes.
- b) *Huaja*: Interesi mbi një shumë të disbursuar të Huasë do të ngarkohet nga data (ekskluzivisht) në të cilën shuma përkatëse e Huasë është paguar nga Llogaria e Huasë e zotëruar nga KfW për Huamarrësin deri në datën (përfshirë) në të cilën pagesat e Huasë janë kredituar në llogarinë e KfW siç është përcaktuar në Nenin 7.3. Interesi do të kalkulohet në përputhje me Nenin 7.1 (*Kalkulimi*). Interesi do të paguhet me vonesë në Datat e Pagesës (siç është definuar në Nenin 4.1.).

6. Shlyerja dhe Parapagimi

6.1 *Kontributi Financiar*: Kontributi Financiar nuk do të jetë i pagueshëm përveç nëse përcaktohet ndryshe në Nenin 11.5.

6.2 *Orari i shlyerjes për Pjesën I*. Huamarrësi do ta shlyej Pjesën I të Huasë siç vijon:

Data e pagesës	Shuma e kështit për tu shlyer	Nr.
30.12.2023	81,967.21 EUR	1
30.06.2024	81,967.21 EUR	2
30.12.2024	81,967.21 EUR	3
30.06.2025	81,967.21 EUR	4
30.12.2025	81,967.21 EUR	5
30.06.2026	81,967.21 EUR	6
30.12.2026	81,967.21 EUR	7
30.06.2027	81,967.21 EUR	8
30.12.2027	81,967.21 EUR	9
30.06.2028	81,967.21 EUR	10
30.12.2028	81,967.21 EUR	11
30.06.2029	81,967.21 EUR	12
30.12.2029	81,967.21 EUR	13
30.06.2030	81,967.21 EUR	14
30.12.2030	81,967.21 EUR	15
30.06.2031	81,967.21 EUR	16
30.12.2031	81,967.21 EUR	17
30.06.2032	81,967.21 EUR	18
30.12.2032	81,967.21 EUR	19
30.06.2033	81,967.21 EUR	20
30.12.2033	81,967.21 EUR	21
30.06.2034	81,967.21 EUR	22
30.12.2034	81,967.21 EUR	23
30.06.2035	81,967.21 EUR	24
30.12.2035	81,967.21 EUR	25
30.06.2036	81,967.21 EUR	26
30.12.2036	81,967.21 EUR	27
30.06.2037	81,967.21 EUR	28
30.12.2037	81,967.21 EUR	29

30.06.2038	81,967.21 EUR	30
30.12.2038	81,967.21 EUR	31
30.06.2039	81,967.21 EUR	32
30.12.2039	81,967.21 EUR	33
30.06.2040	81,967.21 EUR	34
30.12.2040	81,967.21 EUR	35
30.06.2041	81,967.21 EUR	36
30.12.2041	81,967.21 EUR	37
30.06.2042	81,967.21 EUR	38
30.12.2042	81,967.21 EUR	39
30.06.2043	81,967.21 EUR	40
30.12.2043	81,967.21 EUR	41
30.06.2044	81,967.21 EUR	42
30.12.2044	81,967.21 EUR	43
30.06.2045	81,967.21 EUR	44
30.12.2045	81,967.21 EUR	45
30.06.2046	81,967.21 EUR	46
30.12.2046	81,967.21 EUR	47
30.06.2047	81,967.21 EUR	48
30.12.2047	81,967.21 EUR	49
30.06.2048	81,967.21 EUR	50
30.12.2048	81,967.21 EUR	51
30.06.2049	81,967.21 EUR	52
30.12.2049	81,967.21 EUR	53
30.06.2050	81,967.21 EUR	54
30.12.2050	81,967.21 EUR	55
30.06.2051	81,967.21 EUR	56
30.12.2051	81,967.21 EUR	57
30.06.2052	81,967.21 EUR	58
30.12.2052	81,967.21 EUR	59
30.06.2053	81,967.21 EUR	60
30.12.2053	81,967.41 EUR	61

6.3 *Orari i shlyerjes për Pjesën II.* Huamarrësi do ta shlyej Pjesën II të Huasë në 19 këste të njëpasnjëshme gjysmë-vjetore të barabarta, ku e para do të paguhet gjashtë muaj pas gatishmërisë së Projektit për operim por jo më vonë se 30 dhjetor 2016. Nëse ekzekutimi i Kontratës së Eksportit vonohet, KfW do ta ekzaminoj nëse dhe në çfarë kushte mund të zgjatet afati. Dëshmitë dokumentuese për gatishmërinë e Projektit për operim duhet të jepen në përputhje me konfirmimin e bashkangjitur në këtë Marrëveshje si Aneksi 1. Menjëherë pas përpilimit të Orarit të Shlyerjes për Pjesën II të Huasë, KfW do t'ia komunikojë atë Huamarrësit, duke e bërë këtë Orar të Shlyerjes pjesë integrale të kësaj Marrëveshje.

6.4 *Shumat e pa disbursuara të Huasë.* Shumat e pa disbursuara të Pjesës I të Huasë do të kreditohen në proporcione të barabarta kundrejt të gjitha kësteve të mbetura për ripagim të kësaj Pjese të Huasë, përveç nëse KfW, në diskrecionin e vet, përcakton një model tjetër të kompensimit në një rast të veçantë, sidomos në rast të shumave të vogla. Shumat e pa disbursuara të Pjesës II të Huasë do të kompensohen nga kësteve të fundit të shlyera të kësaj Pjese të Huasë çdo kohë sipas Orarit të Shlyerjes përveç nëse KfW, në diskrecionin e vet, përcakton një model tjetër kompensimi në një rast individual.

6.5 *Disbursimi pas fillimit të shlyerjes.* Nëse ndonjë shumë e Pjesës I apo Pjesës II të Huasë është disbursuar pas fillimit të periudhës përkatëse të shlyerjes, kjo nuk do të ndikoj në Orarin e Shlyerjes së Pjesës korresponduese të Huasë përderisa kësti i shlyerjes, i pagueshëm sipas Orarit të Shlyerjes, në çdo kohë është më i ulët sesa shuma e Huasë së mbetur në atë Pjesë përkatëse. Nëse kësti i i pagueshëm tejkalon shumën e Huasë së mbetur së një Pjesë përkatëse, KfW do ta zvogëloj këstin e shlyerjes, për ndryshimin e shumës që përbënë dallimin dhe do ta rris çdo këst të mbetur për tu paguar në Pjesën përkatëse për shumën që përbënë dallimin e përpjesëtuar me numrin e kësteve të mbetura për tu shlyer. Për kalkulimin e shumës së mbetur të Huasë në Pjesën përkatëse, KfW rezervon të drejtën ti llogaris disbursimet që janë bërë brenda 45 ditëve para Datës së ardhshme të Pagesës, vetëm në Datën e dytë të Pagesës pas disbursimit.

6.6 *Parapagimi:* Të vijueshmet aplikohen për parapagimet:

- a) *Kontributi Financiar.* Kontributi financiar nuk do të jetë i pagueshëm përderisa nuk përcaktohet ndryshe në nenin 11.5.
- b) *E drejta për parapagim të Pjesës I.* Huamarrësi mund ta shlyej Pjesën I në tërësi ose pjesërisht në çdo kohë para datës për pagesë me kusht që Pjesa II është shlyer paraprakisht në tërësi apo është shlyer në të njëjtën datë në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshje.
- c) *E drejta për parapagim të Pjesës II.* Huamarrësi mund ta shlyej Pjesën II në tërësi ose pjesërisht por së paku në shumën e një kësti të shlyerjes sipas Nenit 6.3 para maturitetit kundrejt pagesës së taksës së parapagimit sipas Nenit 6.6. f).
- d) *Njoftimi.* Parapagimi i një shume të Huasë në përputhje me Nenin 6.6 d) dhe c) i nënshtrohet një njoftimi për parapagim nga Huamarrësi tek KfW jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë bankare para datës kur mendohet të bëhet parapagimi. Ky njoftim është i pakthyeshëm; ai duhet ta specifikojë datën në të cilën do të bëhet parapagimi, shuma që do të parapaguhet si dhe obligon Huamarrësin t'ia paguajë KfW shumën e cekur në datën e cekur.
- e) *Shumat e pagueshme.* Së bashku me parapagimin, Huamarrësi po ashtu do të paguajë këto shuma:
 - aa) çfarëdo tarifë parapagimi e akumuluar si rezultat i parapagimit të shumave të Pjesës II të Huasë; dhe
 - bb) çdo interes i akumuluar në shumën e parapaguar të Huasë deri në datën e parapagimit.
- f) *Kompensimi i parapagimit.* Nëse Huamarrësi e shlyen një shumë të Pjesës II të Huasë para kohës së caktuar, Huamarrësi do t'i paguajë KfW një taksë për parapagim për këtë shlyerje të parakohshme. Tarifa e parapagimit do të llogaritet në bazë të dallimit ndërmjet (i) interesit të cilin KfW ka mundur ta ngarkonte për një shumë sipas Pjesës II të Huasë deri në fund të orarit të mbetur të maturitetit që aplikohet për Huamarrësin nëse Huamarrësi nuk ka shlyer shumën korresponduese të Huasë, dhe (ii) interesin të cilin KfW mund ta fitojë duke ri-investuar shumën korresponduese të Huasë në konsideratë të shlyerjeve të dakorduara e të zbatuara deri në fund të orarit të mbetur të maturitetit, për të cilën dallimi do të zbritet në bazë të lakores së interesit për ri-investime. KfW do ta përcaktoj shumën e kompensimit për parapagim dhe do t'ia komunikoj atë Huamarrësit.

g) *Kompensimi*. Neni 6.4 (Shumat e pa disbursuara të huasë) do të aplikohen *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimit të shumave të Huasë.

6.7 *Orari i rishikuar i shlyerjes*: Në rast të aplikimit të Nenit 6.4 (*Shumat e pa disbursuara të huasë*), Neni 6.5 (*Disbursimi pas fillimit të shlyerjes*) ose Neni 6.6 (*Parapagimi*), KfW do t'i dërgoj Huamarrësit një orar të rishikuar të shlyerjes i cili do të bëhet pjesë integrale e Marrëveshjes dhe do ta zëvendësoj Orarin e Shlyerjes të aplikuar deri atëherë.

7. Kalkulimet dhe Pagesat në përgjithësi

7.1 *Kalkulimi*. Interesi, taksa e angazhimit, interesi i shkeljeve sipas Nenit 7.5, kompensimet paushallë për shumat e papaguara sipas Nenit 7.6, kompensimi i mos-pranimit dhe kompensimi i parapagimit do të kalkuloohen në bazë të vitit 360-ditësh me 30-ditë në muaj.

7.2 *Data e pagesës*. Nëse një pagesë që ka për tu bërë në lidhje me këtë Marrëveshje bëhet e pagueshme në një datë kur bankat nuk punojnë, Huamarrësi duhet ta bëjë këtë pagesë ditën e ardhshme bankare. Nëse dita e ardhshme bankare bien në muajin tjetër kalendarik, kjo pagesë mund të bëhet në ditën paraprake bankare.

7.3 *Numri i llogarisë, koha e kreditimit*. Huamarrësi do të lirohet nga obligimet e pagesës që dalin nga Marrëveshja atëherë dhe për aq sa shuma korresponduese do të kreditohet në llogari të KfW dhe është në disponueshmëri të KfW pa ndonjë ndalesë në Euro dhe jo më vonë se 10:00 paradite në llogarinë e KfW nr. 31.97252611 për KfW, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, BIC KFWIDEFF, me tregues plotësues të datës të pagesës "Ref. YYYYMMDD") apo në ndonjë llogari tjetër të specifikuar nga KfW.

7.4 *Kundër kërkesat e Huamarrësit*. Huamarrësi nuk ka të drejtë të paraqes ndonjë të drejtë të ndalesës ose kompensimi apo të drejtë të krahasueshme karshi obligimeve të pagesës sipas kësaj Marrëveshje, përveç nëse këto të drejta pranohen me aktgjykim deklarativ ose nuk janë kontestuar nga KfW.

7.5 *Interesi për shkelje*. Kjo do të aplikohet nëse nuk paguhet me kohë ndonjë këst i pagueshëm si dhe parapagimet e vonuara.

a) *Pjesa I*. Nëse ndonjë këst i shlyerjes ose parapagimit të Pjesës I sipas Nenit 6.6 (*Parapagimi*) nuk është me kohë në dispozicion të KfW-së kur bëhet i pagueshëm, KfW mundet, pa ndonjë paralajmërim paraprak, të aplikoj interes mbi vonesat mbi Normën Bazë plus 300 pikë bazë në vit për periudhën që fillon në datën e pagesës dhe që përfundon në kohën kur shlyerjet e tilla janë kredituar në llogarinë e KfW të specifikuar në Nenin 7.3. "**Norma bazë**" është norma e interesit e shpallur nga Banka qendrore gjermane (Deutsche Bundesbank) si norma bazë që mbizotëron në datën përkatëse për pagesë. Një interes i tillë i paracaktuar duhet të paguhet menjëherë me kërkesën e parë të KfW-së.

b) *Pjesa II*. Nëse ndonjë këst i shlyerjes ose parapagimit të Pjesës II të Huasë sipas Nenit 6.6 (*Parapagimi*) nuk është me kohë në dispozicion të KfW-së kur bëhet i pagueshëm, KfW mundet, pa ndonjë paralajmërim ta rris normën e interesit të specifikuar në nenin 5.2 b) për vonesat mbi Normën Bazë plus 300 pikë bazë në vit periudhën që fillon në datën e pagesës dhe që përfundon në kohën kur shlyerjet e tilla janë kredituar në llogarinë e KfW të specifikuar në Nenin 7.3.

7.6 *Kompensimi paushall*. Për shumat që nuk janë paguar me kohë (me përjashtim të kësteve të shlyerjes dhe parapagimit të përmendura në Nenin 7.5 (*Interesi për Shkeljet*) KfW mundet, pa ndonjë

paralajmërim paraprak, të kërkoj kompensimin paushall prej 300 pikë bazë mbi mbi Normën Bazë të aplikueshme në datën e pagesës për periudhën që fillon në datën e pagesës dhe që përfundon në datën e pagesës së shumave të vonuara. Kompensimi paushall duhet të paguhet menjëherë pas kërkesës së parë të KfW. Huamarrësi do të jetë i lirë për të provuar se në të vërtetë nuk kanë ndodhur dëme apo që dëmet nuk janë shkaktuar në shumën siç është deklaruar.

7.7 *Kompensimi.* KfW ka të drejtë t'i barazoj pagesat e pranuar kundrejt pagesave që duhet të bëhen sipas kësaj Marrëveshje ose me marrëveshjeve tjera për hua që janë lidhur ndërmjet KfW dhe Huamarrësit.

7.8 *Kalkulimet e bëra nga KfW.* Përveç nëse ka gabime të manifestuara, kalkulimet e shumave nga ana e KfW sipas kësaj Marrëveshje dhe në lidhje me këtë Marrëveshje do të përbëjnë fakte *prima-facie*.

8. Kërkesa negative dhe *Pari Passu* dhe Siguria

8.1 *Asetet e Projektit.* Pa pëlqimin paraprak të KfW, Huamarrësi nuk do t'i vejë peng apo tjetërsoj asetet e projektit, veçanërisht të drejtat nga Kontrata e Eksportit, mallrat e furnizuara dhe shërbimet e ofruara nën këtë Kontratë dhe objektet e Projektit të ndërtuara në lidhje me këto deri në shlyerjen e plotë të Pjesës II të Huasë pa marrëveshjen paraprake të KfW-së.

8.2 *Pari passu.* Deri në masën që lejohet me ligj, Huamarrësi merr përsipër zbatimin e obligimeve *pari passu* sipas kësaj Marrëveshje me të gjitha obligimet tjera ekzistuese ose të ardhshme të pasigurta apo jo të varura për pagesë.

8.3 *Sigurimi.* Në mënyrë që të sigurohen obligimet e Huamarrësit karshi KfW-së në lidhje me këtë Marrëveshje, në lidhje me Pjesën II të Huasë, Agjencia për Ekzekutimin e Projektit do ti sigurojë këto Sigurime në formën dhe përmbajtje të cilën KfW e konsideron të kënaqshme:

a) *Llogaria për Depozitimin e Parasë së gatshme.* Para disbursimit të parë sipas kësaj Marrëveshje, Agjencia për Ekzekutimin e Projektit do të hap një llogari bankare me KfW për depozitim të parasë së gatshme që bartë interes, dhe sipas kërkesave të KfW ("Llogaria për depozitim të parasë së gatshme"). Agjencia për Ekzekutimin e projektit menjëherë duhet të njoftoj KfW-në me shkrim për nënshkrimin e Kontratës së parë për Eksport dhe brenda 7 (shtatë) ditëve pas nënshkrimit të Kontratës së parë për Eksport, do t'i kreditoj 800,000 Euro (me fjalë: tetë qind mijë euro) në Llogarinë e Depozitimit të Parasë së gatshme. Duhet të përmend "TMa3, Llogaria për Depozitimin e Parasë së gatshme për Projektin BMZ-nr. 2011.65.604, 2012.66.097" si arsye për transfer dhe duhet ta njoftoj KfW-në me shkrim nëpërmjet korrierit (duke përmendur "Departamentin TMa" në adresë) për secilin transfer në ditën kur transferi është urdhëruar. Agjencia për Ekzekutimin e Projektit duhet që më tej të kreditoj 800,000 Euro (me fjalë: tetë qind mijë euro) në përvjetorin e parë dhe të dytë të nënshkrimit të Kontratës të parë për Eksport në Llogarinë për Depozitimin e Parasë së gatshme (d.m.th. gjithsejtë 1,600.000 (me fjalë: një milion e gjashtëqind mijë euro), në total me pagesën fillestare 2,400.000 (me fjalë: dy milion e katërqind mijë euro). Pasi që Orari i Shlyerjes për Pjesën II të Huasë t'i jetë komunikuar Huamarrësit sipas Nenit 6.3, Agjencia për Ekzekutimin e Projektit ka të drejtë të kërkoj nga KfW-ja deri në tri herë shlyerjen e shumave në Llogarinë për Depozitimin e Parasë së gatshme në qasje të servisimit të borxhit për Pjesën II sipas kësaj Marrëveshje duke përfshirë kryegjënë dhe interesin në një vit kalendarik për vitin paraprak kalendarik. KfW do të jetë vetëm e obliguar t'i transferoj shumat si përmendet më lartë, nëse Huamarrësi në tërësi ka përmbushur obligimet e veta të pagesës kundrejt KfW-së sipas kësaj Marrëveshje në lidhje me Pjesën II të Huasë. Pasi që Huamarrësi ta ketë shlyer Pjesën II të Huasë në tërësi, KfW do t'ia transferoj bilancin e mbetur në Llogarinë e Depozitimit të Parasë së gatshme Agjenciat për Ekzekutimin e Projektit.

Nëse Huamarrësi është në shkelje të pagesës në lidhje me ndonjë interes dhe/ose shumat e kryejësë për pagesë dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshje në lidhje me Pjesën II të Huasë, KfW-ja ka të drejtë ta debitoj Llogarinë e Depozitimit të Parasë së gatshme me shumat e mbetura derisa bilanci i Llogarisë së Depozitimit të Parasë së gatshme të jetë zero. Detajet për Llogarinë e Depozitimit të Parasë së gatshme do të përcaktohen në dokumentin e Sigurisë të ofruar për Llogarinë e Depozitimit të Parasë së gatshme dhe të drejtat e KfW-së në lidhje me të.

b) *Llogaria e të Hyrave*. Para disbursimit të parë sipas kësaj Marrëveshje, Agjencia për Ekzekutimin e Projektit do të hap një llogari sipas kërkesave të KfW-së ku do të paguhet të gjitha të hyrat e huaja të Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit ("Llogaria e të Hyrave"). Agjencia për Ekzekutimin e Projektit do të siguroj me mjete të përshtatshme se të gjitha të hyrat e huaja do të kreditohen vetëm në Llogarinë e të Hyrave. Agjencia për Ekzekutimin e Projektit do të ketë të drejtë të bëjë tërheqje nga Llogaria e të Hyrave në përditshmërinë e saj afariste, me kusht që Huamarrësi nuk është në shkelje të ndonjë nga obligimet e veta për kryejnë dhe/ose interesin kundrejt KfW-së sipas kësaj Marrëveshje në lidhje me Pjesën II të Huasë. Në rast të tillë dhe pasi Agjencia për Ekzekutimin e Projektit ta pranoj një njoftim me shkrim nga KfW-ja, Agjencia për Ekzekutimin e Projektit nuk ka të drejtë të tërheqë asnjë shumë nga Llogaria e të Hyrave derisa KfW-ja të ketë pranuar në tërësi nga bilanci i Llogarisë së të Hyrave shumat për të cilat Huamarrësi është në shkelje të pagesës. Detajet rreth Llogarisë së të Hyrave do të përcaktohen në dokumentin e Sigurisë të ofruar për Llogarinë e të Hyrave dhe të drejtave të KfW-së në lidhje me të.

c) *Procedimi i kërkesave*. Për aq sa KfW të ketë përmbushur kërkesat e veta për pagesë kundrejt Huamarrësit siç përshkruhet në Nenet 8.3 a) dhe/ose 8.3 b) më lartë, KfW-ja do t'i procedoj kërkesat e veta ndaj Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje në lidhje me Huan për Agjencinë për Ekzekutimin e Projektit.

d) *Renditja e Sigurimeve*. Vetëm kur bilanci i Llogarisë për Depozitimin e Parasë është zero, KfW-ja ka të drejtë të bëjë një tërheqje nga Llogaria e të Hyrave siç përcaktohet në dokumentin e Sigurisë në lidhje me Llogarinë e të Hyrave dhe të drejtave të KfW-së në lidhje me të.

8.4 *Kostoja*. Kostoja e përgatitjes së dokumenteve përkatëse ligjore të Sigurisë dhe të opinioneve ligjore nga një kompani ligjore e pranueshme për KfW- do të bartet nga Agjencia për Ekzekutimin e Projektit.

8.5 *Agjenti i Sigurisë*. KfW do të ketë të drejtë të caktoj një agjent i cili në emër të saj do t'i ushtroj të drejtat që rrjedhin nga Siguria e krijuar në rast se KfW duhet të përdor Sigurinë. Kostot e kësaj agjencie do të barten nga Agjencia për Ekzekutimin e Projektit.

9. Kostot dhe Pagesat Publike

9.1 *Nuk ka zbritje ose ndalesa*. Huamarrësi do të kryej të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa ndonjë zbritje për taksa, pagesa tjera publike ose edhe shpenzime tjera. Në rast se Huamarrësi është i obliguar me ligj, ose për arsye tjera të aplikoj zbritje ose ndalesa nga pagesat, pagesat e bëra nga Huamarrësi do të rriten për atë shumë në mënyrë që KfW-ja të pranojë në shumë të plotë pagesën e parashikuar me Marrëveshje pas zbritjes së taksave dhe pagesave tjera.

9.2 *Shpenzimet*. Huamarrësi do t'i bartë të gjitha shpenzimet që paraqiten në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e huas, sidomos dërgesat dhe kostot e transferit (duke përfshirë dhe taksat e konvertimit), si dhe shpenzimet e bëra për mirëmbajtjen ose fuqizimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha dokumenteve tjera të lidhura me këtë Marrëveshje përfshirë edhe të gjitha të drejtat që rezultojnë nga kjo Marrëveshje.

9.3 *Taksat dhe pagesat tjera.* Huamarrësi do t'i bartë të gjitha taksat dhe pagesat tjera publike që gjenerohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë që kanë të bëjnë me lidhjen dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshje. Nëse ndonjë prej këtyre taksave apo pagesave gjenerohen brenda Republikës Federale të Gjermanisë, Huamarrësi do t'i paguajë ato vetëm në shumën e gjeneruar si rezultat i iniciativës së Huamarrësit. Nëse KfW-ja i parasheh këto taksa apo pagesa, Huamarrësi do t'i transferoj ato pa vonesë me kërkesë në llogarinë e KfW-së siç specifikohet në Nenin 7.3. Neni 7 aplikon mutatis mutandis.

9.4 *Lirimi nga taksat.* Para disbursimit së parë nga Kontributi Financiar dhe Huaja, Huamarrësi do të paraqes fakte tek KfW-ja duke dëshmuar se KfW-ja është liruar nga të gjitha taksat në të hyra nga interesi, komisionet dhe pagesat e ngjashme në Republikën e Kosovës me rastin e dhënies së Kontribut Financiar dhe Huasë.

10. Obligimet Speciale

10.1 Implementimi i projektit dhe informatat e veçanta. Agjencia për Ekzekutimin e Projektit

a) do të përgatis, implementoj, operoj dhe mirëmbaj Projektin në pajtim me praktikat e shëndosha financiare dhe teknike, dhe në pajtueshmëri me konceptin e Projektit të dakorduar nga Huamarrësi dhe KfW;

b) përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit do t'ia caktoj këshilltarëve të pavarur dhe të kualifikuar të Inxhinierisë, si dhe implementimin e Projektit do t'i caktoj kompanive të kualifikuara;

c) do ta jap kontratën për mallra dhe shërbime që do të financohet nga Kontributi Financiar dhe Huaja pas një procesi paraprak tenderimi konkurrues ndërkombëtar,

d) do të mbajë librat dhe shënimet ose siguroj që librat dhe shënimet të mbahen në mënyrë që pa mëdyshje tregojnë të gjitha shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe qartazi identifikojnë mallrat dhe shërbimet e financuara nga Kontributi Financiar dhe Huaja;

e) do të mundësojë që përfaqësuesit e KfW-së të inspektojnë në çdo kohë këto libra dhe shënime si dhe çfarëdo dokumentacioni tjetër relevant për implementimin dhe operimin e Projektit, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha pikat që ndërlidhen me të;

f) do të ofroj KfW-së informatat dhe shënimet për Projektin dhe progresin e mëtutjeshëm sipas kërkesës së KfW-së;

g) me pajtimin e vet

aa) t'i përcjellë tek KfW-ja çdo kërkesë që pranohet nga Huamarrësi ose Agjencia për Ekzekutimin e Projektit nga OECD ose anëtarët e saj me të ashtuquajturën "Marrëveshje për Transparencë të Huas së Unifikuar të ODA" pas dhënies së kontratës për mallra dhe shërbime që do të financohen nga Kontributi Financiar dhe Huaja si dhe do t'i koordinojë me KfW-në përgjigjet në çfarëdo kërkesë, dhe,

bb) informojë KfW-në për çfarëdo rrethane që e përjashton apo seriozisht rrezikon implementimin, operimin ose qëllimin e projektit.

10.2 *Marrëveshja e Veçantë.* Agjencia për Ekzekutimin e Projektit dhe KfW do të përcaktojnë detajet e Nenit 10.1 me një marrëveshje të veçantë.

10.3 Huamarrësi dhe Agjencia për Ekzekutimin e Projektit do të:

a) sigurojnë financimin e plotë të Projektit dhe sipas kërkesës, t'i ofroj KfW-së dëshmi që tregojnë se shpenzimet që nuk janë paguar nga Huaja dhe Kontributi Financiar janë mbuluar; dhe

b) në pajtim të plotë dhe me përpikëri të informojë KfW-në (i) për ndodhitë apo ndodhitë e mundshme të Ngjarjes së Shkeljes dhe (ii) për ndonjë rrethanë që do të përjashtoj apo seriozisht rrezikoj implementimin, operimin dhe qëllimin e Projektit.

10.4 Huamarrësi do ta asistojë Agjencinë për Ekzekutimin e Projektit konform praktikave të shëndosha financiare dhe inxhinerike në implementimin e Projektit dhe kryerjen e obligimeve të Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe në veçanti, t'i jap Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit të gjitha lejet e nevojshme për implementimin e Projektit.

10.5 *Pajtueshmëria*. Huamarrësi dhe Agjencia për Ekzekutimin e Projektit do të sigurojnë se personave të cilëve u besohet përgatitja dhe implementimi i Projektit, dhënia e çfarëdo kontrate për mallra dhe shërbime që duhet financuar, dhe duke kërkuar shumat e huas apo/ose të Kontributit Financiar të mos kërkoj, pranoj, bëjë, jap, premtoj ose pranoj premtime për pagesa jologjore ose përparësive të tjera në lidhje me këto aktivitete.

10.6 *Transporti i mallrave*. Dispozitat e caktuara në Marrëveshjen Qeveritare, të cilat janë të njohura për Huamarrësin dhe Agjencinë për Ekzekutimin e Projektit, do të vlejnjë për transportin e mallrave që do të financohen nga Huaja apo Kontributi Financiar.

11. Arsyet për Anulimin e Huasë dhe pezullimin e Kontributit Financiar

11.1 *Ngjarjet e Shkeljes*. KfW mund të ushtroj të drejtat e përcaktuara me Nenin 11.2 (*Pasojat ligjore në një Ngjarje të Shkeljes*) nëse ndodh një ngjarje e cila paraqet arsye materiale. Në veçanti, ngjarjet e ardhshme do të paraqesin arsye materiale:

- a) Huamarrësi dështon të kryej obligimin e pagesës ndaj KfW-së si dhe nëdatën e caktuar;
- b) obligimet me këtë Marrëveshje ose me marrëveshje të veçante që i përkasin kësaj Marrëveshjeje janë shkelur nga Huamarrësi apo/ose nga Agjencia për Ekzekutimin e Projektit;
- c) Huamarrësi dhe Agjencia për Ekzekutimin e Projektit nuk janë në gjendje të tregojnë se shumat e Kontributit Financiar dhe Huasë janë përdorur për qëllimet e përcaktuara;
- d) kjo marrëveshje apo çfarëdo marrëveshje e lidhur ndaras ka pushuar të jetë obliguese pjesërisht apo tërësisht për Huamarrësin apo Agjencinë për Ekzekutimin e Projektit ose nuk është më e zbatueshme ndaj Huamarrësit apo/ose ndaj Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit;
- e) çdo deklaratë, konfirmim, informatë apo përfaqësim ose garanci e cila sipas opinionit të KfW-së është thelbësore për dhënien dhe mirëmbajtjen e Huas del te jetë e pasaktë, e keqpërdorur apo jo e plotë;
- f) Sigurimi për Huan e Eksportit për kërkesat e KfW-së sipas Pjesës II të Huasë nuk është më në fuqi dhe efektive, pa ndonjë kufizim;

- g) siç mund të vlerësohet arsyeshëm nga KfW-ja, pasuritë, situata financiare apo fitimet e Huamarrësit janë përkeqësuar apo kanë ndodhur rrethana tjera të jashtëzakonshme të cilat e vonojnë apo përjashtojnë përmbushjen e obligimeve me këtë Marrëveshje;
- h) ka luhatje të madhe të vlerës së Sigurimit ose ndonjë Sigurim është ose bëhet i pavlefshëm apo i pazbatueshëm, dhe Agjencia për Ekzekutimin e Projektit dështon të ofroj sigurim të vlefshëm dheekonomikisht ekuivalent brenda katërmëdhjetë ditëve nga koha kur është kuptuar ose koha kur është dashur të kuptohet për këtë ngjarje.

11.2 *Pasojat Ligjore të një Ngjarjeje të Shkeljes*. Nëse njëra nga ngjarjet e përcaktuara në Nenin 11.1 është paraqitur dhe nuk është zgjedhur në një periudhë brenda pesë ditëve (në rast të Nenit 11.1. a) ose në rastet tjera të specifikuar në nenin 11.1, nuk është zgjedhur në periudhën e përcaktuar nga KfW-ja, që nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, KfW mund ta anuloj Huan në tërësi ose pjesërisht me pasojë që:

- a) Obligimet e veta karshi Huasë anulohen, dhe
- b) KfW mund të kërkojë shlyerjen e tërësishme ose pjesëshme të shumës së mbetur të Huasë me interesin e grumbulluar dhe çfarëdo shume tjetër të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, me Nenin 7.5 (*Interesi i Shkeljes*) dhe 7.6 (*Kompensimi Paushall*) duke aplikuar për shumat e përshpejtuara mutatis mutandis.

11.3 *Kompensimi për dëmtimet*. Në rast se Huaja anulohet tërësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë kompensimin e mos pranimit në pajtim me Nenin 3.7 (*Kompensimi për mos pranim*) dhe/ose kompensimin e parapagimit në pajtim me Nenin 6.5 e) (*Kompensimi i Parapagimit*).

11.4 *Pezullimi i Disbursimeve nga Kontributi Financiar*. KfW nuk mund të pezullojë disbursimet e Kontributit Financiar përveç nëse:

- a) Huamarrësi ka dështuar të kryej obligimet ndaj KfW-së për ta bërë pagesën me kohë,
- b) Janë shkelur obligimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të veçanta në lidhje me këtë Marrëveshjeje,
- c) Huamarrësi dhe/ose Agjencia për Ekzekutimin e Projektit nuk është në gjendje të dëshmojë se shumat e Kontributit Financiar dhe/ose Huasë janë përdorur për qëllimin e përcaktuar,
- d) ndodhin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë apo seriozisht rrezikojnë implementimin, operimin dhe qëllimin e Projektit.

11.5 *Shlyerja e Kontributit Financiar*. Nëse njëra nga situatat e specifikuar në Nenin 11.4 b) ose c) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar në periudhën e përcaktuar nga KfW, e cila do të jetë së paku 30 ditë, KfW mund të,

- a) në rastin e specifikuar në Nenin 11.4 b), të kërkojë shlyerje të menjëhershme të Kontributit Financiar; dhe
- b) në rastin e specifikuar në Nenin 11.4 c), të kërkojë shlyerje të menjëhershme të shumave të tilla të Kontributit Financiar kur Huamarrësi apo/ose Agjencia për Ekzekutimin e Projektit nuk janë në gjendje të dëshmojnë që shumat janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

12. Përfaqësimi dhe Deklaratat

12.1 *Përfaqësimi i Huamarrësit dhe Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit.* Ministri i Financave dhe personat e caktuar nga ai ose ajo tek KfW-ja dhe të autorizuar përmes nënshkrimeve mostër të vërtetuara nga ai apo ajo do të përfaqësojnë Huamarrësin në realizimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit dhe personat e caktuar nga ai ose ajo tek KfW-jaë dhe të autorizuar me nënshkrimet mostër të vërtetuata nga ai apo ajo do të përfaqësojnë Agjencinë për Ekzekutimin e Projektit në realizimin e kësaj Marrëveshjeje. Autorizimet e përfaqësimit nuk do të skadojnë përderisa revokimet e tyre të menjëhershme nga përfaqësuesit e autorizuar në atë kohë nuk janë pranuar nga KfW-ja.

12.2 *Adresat.* Njoftimet ose deklaratat në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Duhet të dërgohen në origjinal ose – me përjashtim të kërkesave për disbursim – me faksimil. Të gjitha njoftimet ose deklaratat e bëra në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohen në këto adresa:

Për KfW:

KfW
LEa3
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Germany
Fax: +49 69 7431-3559

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Ndërtesa e Re Qeveritare
Rr. Nëna Terezë
10000 Prishtinë
Kosovë
Fax: +381 38 21 31 13

Për Agjencinë që Ekzekuton Projektin:

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh. a.
(KOSTT)
Rruga Iljaz Kodra p.n.
10000 Prishtinë
Kosovë
Fax: +381 38 500 201

Për të lehtësuar procedurat e brendshme brenda administratës së Huamarrësit në lidhje me këtë Marrëveshje, KfW-ja, vetëm për qëllime të informimit, do t'i ofrojë Huamarrësit kërkesat e pagesës (me e-mail ose faks, shih më poshtë), për pagesat e bëra ose të kredituara në llogarinë e Projektit të mbajtur nga KfW-ja. Kjo nuk do të ndikojë në obligimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje, në veçanti pa kufizim në obligimet për të paguar interesin për Hua dhe shlyer Huanë në datat e specifikuar në këtë Marrëveshje.

Thesari - Ministria e Financave

Ndërtesa e re e Qeverisë, kati 10,

10000 Prishtinë, Kosovë

Fax: +381 38 212 362 |

E- mail: aneziraj@mfe-ks.org,

ahaxhiaj@mfe-ks.org

13. Dispozitat e Përgjithshme

13.1 *Dita bankare.* Kur Marrëveshja i referohet “**ditës bankare**”, që nënkupton ditën, përveç të Shtunës ose të Dielës, në të cilën bankat komerciale janë të hapura për punë në Frankfurt am Main.

13.2 *Vendi i ekzekutimit.* Vendi i ekzekutimit për të gjitha obligimet e parashikuara me këtë Marrëveshje është Frankfurt am Main.

13.3 *Pavlefshmëria e pjeshme dhe zbrazëtitat.* Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose nëse ka zbrazëti në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikoj në vlefshmërinë e dispozitave të mbetura. Palët në këtë Marrëveshje do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë tjetër të vlefshme ligjore që i përshtatet më shumë frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët do të plotësojnë çfarëdo zbrazëtitare në dispozita me një dispozitë ligjorë të vlefshme që i përshtatet sa më shumë frymës dhe qëllimit të Marrëveshjes.

13.4 *Pavarësia Ligjore.* Kjo Marrëveshje dhe Kontrata e Eksportit janë dy marrëveshje të ndara ligjore. Huamarrësi nuk mund, gjatë kryerjes së obligimeve, të parashtrij mbrojtjet që dalin si rezultat i Kontratës së Eksportit.

13.5 *Forma e Shkruar.* Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Marrëveshje duhen të jenë me shkrim që të jenë efektive. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë e formës së shkruar duhet të deklarohet me shkrim nga palët.

13.6 *Caktimi.* Huamarrësi dhe/ose Agjencia për Ekzekutimin e Projektit nuk mund të vendosin apo transferojnë, lënë peng apo vënë hipotekë çfarëdo kërkesë sipas kësaj Marrëveshjeje apo dokumenteve të Sigurisë.

13.7 *Ligji i aplikueshëm.* Kjo Marrëveshje rregullohet me ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë.

13.8 *Periudha e kufizimeve:* Çdo kërkesë e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje do të skadojë pas pesë viteve nga fundi i vitit në të cilin kjo kërkesë është paraqitur dhe për të cilën KfW-ja ka njohuri për rrethanat që e përbëjnë një kërkesë të tillë apo ka mundur të ketë njohuri pa neglizhencë madhore.

13.9 *Kontestet Ligjore*

a) *Arbitrazhi.* Të gjitha kontestet që dalin në lidhje me Marrëveshjen aktuale do të zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një tribunal i arbitrazhit. Në lidhje me këtë, do të aplikohet si vijon:

aa) Tribunali i arbitrazhit do të përbëhet nga tre arbitra të cilët do të emërohen dhe veprojnë në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Odës Ndërkombëtare Ekonomike (ICC) të aplikueshme kohë pas kohe.

bb) Procedurat e arbitrazhit do të kryhen në Frankfurt am Main. Veprimet do të kryhen në gjuhën Angleze.

b) *Juridiksioni.* Përveç kësaj, KfW ka të drejtë të inicioj veprime ligjore në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm (ordentliche Gerichte) në Frankfurt am Main ose në ndonjë gjykatë tjetër të juridiksionit kompetent, përveç nëse çështja e kontestuar është subjekt i procedurave të arbitrazhit ndërmjet palëve. Huamarrësi, në mënyrë të pakthyeshme pranon juridiksionin e një gjykate të tillë.

13.10 *Transmetimi i informacionit.* KfW mund të shpallë informata për lidhjen dhe realizimin e Marrëveshjes tek Agjencia e Sigurimit të Huasë së Eksportit (përfshirë edhe Institucionet që kontrollojnë apo rregullojnë këtë Agjenci të Sigurimit dhe përfaqësuesit e saj). KfW dhe Agjencia për Sigurim të Huasë së Eksportit kanë të drejtë të shpërndajnë informata për Kontributin Financiar, Huan dhe Projektin duke përfshirë dhe dhënien e kontratës për mallra dhe shërbime të financuar nga Kontributi Financiar dhe Huaja tek organizatat ndërkombëtare që merren me mbledhjen e të dhënave

statistikore, veçanërisht në lidhje me aspektet e servisimit të borxhit dhe/ose me mbledhjen dhe publikimin e të dhënave për dhënien e kontratës për mallra dhe shërbime të financuara nga Kontributi Financiar dhe Huaja. E drejta për të shpërndarë informatën tek organizatat ndërkombëtare përfshinë edhe të drejtën që të shpërndajnë këtë informatë direkt tek anëtarët e këtyre organizatave.

13.11 *Hyrja në Fuqi*. Kjo Marrëveshje nuk do të hyj në fuqi përderisa:

a) nuk është nënshkruar nga Ministri i Financave, i cili nënshkrim do të pranohet vetëm kur këtë Marrëveshje ta ratifikoj Parlamenti i Huamarrësit, dhe

b) ratifikimi të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në Prishtinë, dhe

c) (ii) KfW të ketë njoftuar Huamarrësin se KfW ka pranuar të gjitha autorizimet qeveritare të nevojshme në lidhje me këtë Marrëveshje për Hua, cilado që ndodh më parë. Nëse kushtet e cekura më lartë nuk përmbushen deri më 31.12.2014, kjo Marrëveshje nuk do të hyj në fuqi dhe nuk do të ketë efekt.

Kjo marrëveshje realizohet në tre origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,

Prishtina,

këtë ditë të vitit 2013

këtë ditë të vitit 2013

KfW

Republika e Kosovës
Përfaqësuar nga Ministria e Financave
e Republikës së Kosovës

Operator Sistemi, Transmisioni dhe
Tregu sh. a. (KOSTT)

[Logo e huamarrësit]

KfW

Departament L III a 3

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Gjermani

Konfirmimi i Gatishmërisë për Operim

Përshkrimi i shkurtër i projektit: - Përmirësimi i rrjetit të transmisionit (Programi i Sektorit të Energjisë, Faza IV dhe V)

BMZ ID 2011.65.604,2012.66.097

Data e Marrëveshjes për Hua dhe Financim: _____

Sipas nenit 6.2. të Marrëveshjes për Hua dhe Financimi ne me këtë konfirmojmë se Projekti ka qenë i gatshëm për operim që nga

(Vendi)

(Data)

(Nënshkrimi i Huamarrësit)

(Vendi)

(Data)

Forma e Opinionit Ligjor të Këshilltarit Ligjor të Huamarrësit

Logo e këshilltarit ligjor

KfW

(data)

Departament L III a 3

Attn: Dr. Wilderich Hörr

Palmengartenstrasse 5 - 9

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Republika Federale e Gjermanisë

Marrëveshje për Hua dhe Financim datëse lidhur ndërmjet KfW, Republikës së

Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave (“Huamarrësi”) dhe Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh. a. (KOSTT) (“Agjencia për Ekzekutimin e Projektit”) për një shumë e cila nuk tejkalon agregatin prej 23.500.000 EUR, e përbërë prej një Kontributi Financiar në shumë prej 3.000.000 EUR dhe një Hua në shumë prej EUR 20.500.000.

Të nderuar Zotëri,

Unë jam [Ministër i Drejtësisë së][këshilltar ligjor i] [udhëheqësi i departamentit të (ju lutem specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) i] Republikës së Kosovës. Kam vepruar në cilësinë e tillë në lidhje me një Marrëveshje për Hua dhe Financimin (“**Marrëveshja**”) e datës e lidhur ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë për Ekzekutimin e Projektit dhe juve në lidhje me Kontributin Financiar që do të jepet nga ju për Huamarrësin në shumë prej 3.000.000 EUR,-- dhe Huaja në shumë prej 20.500.000 EUR.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Kam shqyrtuar:

1.1 një origjinal autentik të nënshkruar të Marrëveshjes;

1.2 Dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, në veçanti:

(a) Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të datës , të publikuar në. , Nr.
.. , faqe. , të ndryshuar;

(b) Ligjin (et) Nr. të datës , të publikuar anë , Nr. , faqe. , të
ndryshuar [ju lutem paraqitni këtu, nëse ligjet ekzistuese (p.sh ligjet buxhetore) lidhur me huazimin e
parave nga Republika e Kosovës];

(c) [ju lutem referohuni dokumenteve tjera p.sh. dekretet ose rezolutat nga organet
qeveritare ose administrative të Kosovës lidhur me lidhjen e marrëveshjeve për Hua nga Kosova në
përgjithësi ose në lidhje me lidhjen e Marrëveshjes]; dhe

(d) Përmbledhjen e Procesverbalit të Negociatave për Bashkëpunim në Zhvillim të datës 19 shtator
2008 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së
Kosovës.

dhe ligjet tjera, rregulloret, certifikatat, shënimet, regjistrimet dhe dokumentet si dhe kam bërë hetime
tjera të cilat i kam konsideruar të nevojshme ose dëshirueshme për qëllim të dhënies së këtij opinioni.

2. Opinioni

Për qëllim të Nenit 3.5 a) dhe Nenit 9.4 të Marrëveshjes, unë jam i mendimit se sipas ligjeve të
Republikës së Kosovë të kësaj date:

2.1 Sipas Nenit /.....Kushtetutës të ligjit për [ju lutem specifikoni sipas nevojës] Huamarrësi ka të
drejtë të hyjë në Marrëveshje dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar
ekzekutimin, dorëzimin dhe kryerjen e Marrëveshjes, në veçanti me duke u mbështetur në

(a) Ligjin(et) Nr. të datës të Parlamentit të Republikës së Kosovës për ratifikimin e
Marrëveshjes/miratimin e ekzekutimit, dorëzimit dhe zbatimit të Marrëveshjes nga Huamarrësi /.... [ju
lutem paraqitni sipas nevojës];

(b) Rregulloren(et) Nr..... të datës të Kabinetit të Ministrave / të komitetit shtetëror për
Hua/..... [ju lutem paraqitni organet qeveritare ose administrative të Kosovës sipas nevojës];

(c) [ju lutem referohuni rezolutave tjera, vendimeve, etj].

2.2 Znj. / Z.(dhe Znj/Z.) është (janë) të autorizuar si duhet nga
..... [p.sh. me ligj për shkak të pozitës së saj/tij (si Ministër i .../ si...) me vendim qeveritar
..... me fuqinë e ligjore të datës etj] që vetëm/së bashku të nënshkruajnë Marrëveshjen
në emër të Huamarrësit. Marrëveshja si e tillë është nënshkruar nga Znj./Z. (dhe Znj./Z.)
është ekzekutuar si duhet në emër të Huamarrësit dhe përfaqëson obligim ligjor të Huamarrësit të
zbatueshëm kundrejt tij me ligj në pajtim me kushtet e saj.

[**Alternativa 1** për Seksionin 2.3, për tu përdorur si shtesë e dokumenteve të specifikuar në
Seksionin 2.1 dhe 2.2 autorizimet zyrtare përkatëse, etj duhet të merren sipas ligjeve të Republikës
së Kosovës]

2.3 Për ekzekutimin dhe zbatimin e Marrëveshjes (përfshirë mos kufizimin në marrjen dhe transferin tek KfW të të gjitha shumave të pagueshme në valutat e specifikuara) miratimet zyrtare, autorizimet, licencat, rregulloret dhe/ose pëlqimet vijuese janë marrë dhe janë në fuqi dhe kanë efekt të plotë:

(a) Miratimi i [Bankës Qendrore/Bankës Kombëtare], data
....., Nr.;

(b) Pëlqimet e [Ministrit / Ministrisë së], të datës, Nr.
.; dhe

(c) [ju lutem paraqitni autorizimet tjera zyrtare, licencat dhe/ose pëlqimet].

Nuk nevojiten autorizime zyrtare, pëlqime, regjistrime dhe/ose miratime të ndonjë autoriteti qeveritar, ose agjenci (Bankës Qendrore/Bankës Kombëtare të Republikës së Kosovës) ose gjykatë apo edhe këshillime në lidhje me ekzekutimin dhe zbatimin e Marrëveshjes nga Huamarrësi (përfshirë këtu edhe mos kufizimin në marrjen dhe transferin tek KfW të të gjitha shumave të pagueshme në valutën e specifikuar) si dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e obligimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes.

[Alternativa 2 për Seksionin 2.3. për tu përdorur si plotësim i dokumenteve të specifikuara në Seksionin 2.1 dhe 2.2 nuk duhet të merren autorizime zyrtare etj, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës:]

2.3 Nuk nevojiten autorizime zyrtare, pëlqime, regjistrime dhe/ose miratime të ndonjë autoriteti qeveritar, ose agjenci (Bankës Qendrore/Bankës Kombëtare të Republikës së Kosovës) ose gjykatë apo edhe këshillime në lidhje me ekzekutimin dhe zbatimin e Marrëveshjes nga Huamarrësi (përfshirë këtu edhe mos kufizimin në marrjen dhe transferin tek KfW të të gjitha shumave të pagueshme në valutën e specifikuar) si dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e obligimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes.

2.2 Nuk duhet të paguhet taksë për vulë ose taksë e ngjashme ose detyrim në lidhje me vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e Marrëveshjes.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar këtë Marrëveshje dhe dorëzimin për arbitrazh në pajtim me Nenin 13.9 të Marrëveshjes janë të vlefshme dhe obliguese. Vendimet dhe gjykimet e Arbitrazhit të marra në gjykatat e Republikës Federale të Gjermanisë kundër Huamarrësit do të njihen dhe zbatohen në Republikën e Kosovës sipas rregullave vijuese:..... [ju lutem paraqitni traktatin e aplikueshëm (nëse ka) p.sh. Konventa e Nju Jorkut të vitit 1985 dhe/ose parimet bazë lidhur me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit në Kosovë].

2.6 Gjykatat e Republikës së Kosovës kanë lirinë të japin aktgjykim të shprehur në valutën ose valutat e specifikuara në Marrëveshje.

2.7 Huazimi nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes si dhe ekzekutimi dhe zbatimi i Marrëveshjes nga Huamarrësi përfaqësojnë akte private dhe komerciale dhe jo akte publike. As Huamarrësi e as prona e tij nuk ka imunitet nga arbitrazhi, padia, ekzekutimi, bashkëngjitja ose ndonjë proces tjetër ligjor.

2.8 Marrëveshja për Bashkëpunim është në fuqi dhe ka efekt të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës. [Sipas Nenit 23 të Marrëveshjes për Bashkëpunim] [si alternativë ju lutem specifikoni traktatin ose ligjet e aplikueshme ose rregulloret] Huamarrësi nuk obligohet të bëjë zbritje ose ndalesa nga pagesa që Huamarrësi duhet të bëjë sipas Përmbledhjes së Procesverbalit të Negociatave për Bashkëpunim në Zhvillim të datës 19 shtator 2008 ndërmjet Qeverisë të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2.9 KfW nuk është dhe nuk do të konsiderohet rezident, me banim të përhershëm, kur kryen afarizëm ose është subjekt i tatimit në Kosovë me arsyetim vetëm për ekzekutim, kryerje ose zbatim të Marrëveshjes. Nuk është e nevojshme ose këshillueshme që KfW të licençohet, kualifikohet ose ndryshe të ketë të drejtë të afaroj ose që KfW të emëroj agjent ose përfaqësues në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, obligimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes përbëjnë obligime direkte të vlefshme dhe obliguese dhe ligjërish të pakushtëzuara të Huamarrësit të cilat janë të zbatueshme kundër Huamarrësit në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

Ky opinion ligjor është i kufizuar në ligjet e Republikës së Kosovës.

.....,

(vendi)

(data)

[Nënshkrimi]

Emri:

Shtesat:

Vërejtje: Ju lutem bashkëngjitni kopjet e dokumenteve dhe dispozitave ligjore të referuara më lartë në Seksionin 1.2 (a) deri 1.2 (c) dhe Seksionet 2.1 deri në 2.6 (në lidhje me ligjet e gjata ose Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do të ishte e mjaftueshme një kopje të dispozitave relevante) dhe gjithashtu ofroni KfW-së një kopje të përkthimit të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të secilit dokument të përmendur më lartë nëse dokumentet e tilla nuk janë nxjerrë në gjuhën angleze ose gjermane si gjuhë zyrtare.

MARRËVESHJA PËR NËN-HUAZIM

deri në

23,500,000. Euro

Data _____

ndërmjet

Republikës së Kosovës

MINISTRIA E FINANCAVE

("Huadhënësi")

dhe

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu ("KOSTT")

("Huamarrësi")

PROJEKTI:

- Përmirësimi i rrjetit të transmisionit -

(Programi i sektorit të energjisë, faza IV dhe V)

Kjo Marrëveshje për Nën-huazim ("Marrëveshja") është ekzekutuar nga dhe ndërmjet:

Ministria e Financave ("Huadhënësi ") me adresën e saj në Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave (" Ministri "); dhe

Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) sh.a. ("Huamarrësi") me adresën e saj në Prishtinë, rruga Ilaz Kodra pn, përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i saj.

Bazuar në Marrëveshjen e Huasë dhe Financimit, datë 23 shtator 2013, ("**Marrëveshja për Kredi dhe Financim**") e bërë në mes të Ministrisë së Financave në emër të Republikës së Kosovës dhe KfW, për **Përmirësimin e rrjetit të transmisionit** (Programi i Sektorit të Energjisë Faza IV dhe V) ("Projekti")

Huadhënësi pajtohet për nën-huazojë fonde nga Marrëveshja e Financimit, datë 23 shtator 2013, ("**Marrëveshja për Kredi dhe Financim**") e bërë në mes të Ministrisë së Financave në emër të Republikës së Kosovës dhe KfW, për **Përmirësimin e rrjetit të transmisionit** (Programi i Sektorit të Energjisë Faza IV dhe V) (BMZ ID 2011.65.604, 2012.66.097).

Neni 1 Shuma dhe qëllimi i huasë

1.1 Huadhënësi do t'i jap Huamarrësit një hua që nuk kalon një total prej: EUR **23.500.000** (njëzet e tre milionë e pesëqind mijë):

Huaja nuk duhet të kalojë: EUR 23,500,000

- Në pjesën e I deri në EUR 8,000,000 (Pjesa I)
- Në pjesën e II deri në EUR 15,500,000 (Pjesa II)

1.2 Huamarrësi do të përdorë huanë ekskluzivisht për të paguar shpenzimet e bëra në lidhje me Projektin ("**Kostot e Projektit**"), siç përshkruhet në "**Marrëveshjen e Huasë dhe Financimit**") e bërë në mes të Ministrisë së Financave në emër të Republikës së Kosovës, KOSTT (Agjensioni për Ekzekutimin e Projektit) dhe KfW. Huamarrësi dhe KfW do të përcaktojnë detajet e projektit, kostot e Projektit që do të financohen, kushtet që lidhen me Sigurimin e Kredive të Eksportit si dhe Kontratë Eksporti dhe, nëse është e aplikueshme, përgjegjësitë që rezultojnë nga termat dhe kushtet e Sigurimit të Kredive të Eksportit.

Pjesa II e huasë do të përdoret ekskluzivisht për të financuar furnizimet dhe shërbimet e ofruara në bazë të një kontrate apo kontratat e ndryshme të eksportit ende për t'u tenderuar (tutje të referuara si "**Kontratë eksporti**") financimi i të cilit do të mbulohet nga Sigurimi i Kredisë të Eksportit i pranueshëm për KfW.

1.3 *Taksat, tarifat, detyrimet doganore.* Taksat dhe tarifat e tjera publike që përballohen nga Huamarrësi, si dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Huaja.

Neni 2 Disbursimi

- 2.1 Në varësi të kushteve të përcaktuara në nenin 3.5 të **Marrëveshjes së Huasë dhe të Financimit**, të gjitha disbursimet nga KfW-ja do të bëhen direkt për Huamarrësin si Agjensioni për Ekzekutimin e Projektit sipas kushteve dhe në përputhje me Marrëveshjen e Huasë dhe Financimit. Në një marrëveshje të veçantë, huamarrësi dhe KfW do të specifikojnë procedurën e disbursimit, veçanërisht provat që duhet të jepen nga huamarrësi që dëshmon se fondet e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar në këtë Marrëveshje ose në Marrëveshjen e Huasë dhe Financimit.
- 2.2 Të gjitha implikimet financiare që mund të lindin nga neni 3.3, 3.6 dhe 3.7 të Marrëveshjes së Huasë dhe të Financimit do të përballohen nga huamarrësi.
- a. Pjesë I do të disbursohet në përputhje me ecurinë e projektit dhe me kërkesë të Huamarrësit.
 - b. Pjesa II do të disbursohet në përputhje me kryerjen e furnizimeve dhe shërbimeve të rënë dakord në Kontratë eksporti nga një Agjenci e Eksportit të Kredive.
- 2.2 Procedura e detajuar e disbursimit, orari i disbursimit, dhe në veçanti dëshmitë që provojnë se shumat e kërkuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar në këtë Marrëveshje, janë përcaktuar në Marrëveshjen e veçantë ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit sipas nenit 3.2 të Marrëveshjes së Financimit dhe Huasë.
- 2.3 Në rast se KfW refuzon të bëjë disbursimet për Huamarrësin, sepse ekzekutimi i kontratave për mallra dhe shërbime janë vonuar, është përgjegjësi e Huamarrësit për të negociuar me KfW dhe më pas të njoftojë Huadhënësin të ndonjë marrëveshjeje mbi ndryshimet e afateve kohore në Marrëveshjen e Huasë dhe Financimit dhe në përputhje, çdo amendament që është i nevojshëm sipas kësaj Marrëveshje.

Neni 3
Tarifa e zotimit, Pagesat e Shërbimit të Borxhit, dhe Parapagimi

- 3.1 Huamarrësi do të paguaj, nga burimet e veta, **një tarifë të pakthyeshme zotimi** prej 0.25% p.a.mbi shumat e padisbursuara të huasë.Tarifa e zotimit do të llogaritet sipas Nenit 4.1 të Marrëveshjes së Huasë dhe të Financimit. Ajo do të jetë e shlyer çdo gjysmë-vit në pagesat e vonuara në datat e specifikuara më poshtë (secila "Datë e pagesës"):
- a) Para afatit të shlyerjes së kështit të parë të pjesës I dhe II më 30 maj dhe 30 nëntor të çdo viti; për herë të parë me 30 nëntor 2013.
 - b) në datën e duhur të kështit së parë të shlyerjes së Pjesës I dhe II të Huasë, së bashku me kështin e tillë;
 - c) Pas kësaj në datat e duhura të kësteve të shlyerjes sipas nenit 3.6 dhe 3.7 të kësaj Marrëveshjeje.
- 3.2 Huamarrësi do të paguajë, nga burimet e veta, Huadhënësit brenda 60 ditëve pasi kjo Marrëveshje hyn në fuqi, por në çdo rast para disbursimit të parë nga kjo Hua **një tarifë menaxhimi prej 1.00%** të pakthyeshme të shumës kryesore të Pjesës II e përshkruar në nenin 1.1 këtu më lart.
- 3.3 Huamarrësi do të paguajë **interes** të huadhënësit në shumën prej Pjesës II të Huasë në një normë fikse. Norma e interesit do të përcaktohet në përputhje me nenin 5.2 të Marrëveshjes së Huasë dhe të Financimit dhe do të jetë në fuqi pas pranimit nga Huadhënësi dhe Huamarrësi të Njoftimit të Interesit të kërkuar për t'u dhënë nga KfW.
- 3.4 Huamarrësi do të paguajë interes Huadhënësi në shumënprej Pjesës I një normë fikse prej 0.75% p.a. dhe për një afat prej 40 vjetësh përfshirë një grejs periudhë prej 10 vjetësh.
- 3.5 Interesi do të mblidhet nga datat në të cilat disbursimet janë debituar në datat e shlyerjes së kësteve respektive të përmendura në nenin 6.2 dhe 6.3 të Marrëveshjes së Huasë dhe Financimit. Huamarrësi do të paguajë interes Huadhënësi në pagesat e vonuara në mënyrën e mëposhtme dhe në datat e mëposhtme (secila është "Data e pagesës"):
- a. para datës së duhur të shlyerjes së kështit të parë, Huamarrësi do të paguajë tarifë zotimi për Huanë dhe interesit të Huasë çdo gjysmë-çdo vit më 30 maj dhe më 30 nëntor të çdo viti për gjysmë-viti që përfundon pastaj.
 - b. Pas kësaj në datat më tej për shkak të kësteve të shlyerjes në pajtim me nenin 3.5.
- 3.6 Huamarrësi do të ripaguajë shumën e Pjesës II të Huasë tek Huadhënësi, të barabarta në 19 këste gjashtëmuajore të njëpasnjëshme, i pari i cili do të bëhet gjashtë muaj pas datës së gatishmërisë për operimin e projektit, por jo më vonë se më 30 nëntor 2016. Provat qevërtetojnë gatishmërinë për operimin e Projektit do të jepet nëpërmjet një letre konfirmimi qëdërgohet tekHuadhënësi dhe tek KfW. Sapo të krijohet orari i shlyerjes dhe ofruar nga KfW dhe rënë dakord nga Huadhënësi, Huadhënësi do ta dërgojë atë tek Huamarrësi.Orari i shlyerjes në këtë mënyrë, do të përbëjë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje

3.7 Huamarrësi do të ripaguajë shumën e Pjesës I të Huasë tek Huadhënësi si vijon:

Data e pagesës	Shuma e kështit për tu shlyer Nr.	
30.11.2023	131,147.54 EUR	1
30.05.2024	131,147.54 EUR	2
30.11.2024	131,147.54 EUR	3
30.05.2025	131,147.54 EUR	4
30.11.2025	131,147.54 EUR	5
30.05.2026	131,147.54 EUR	6
30.11.2026	131,147.54 EUR	7
30.05.2027	131,147.54 EUR	8
30.11.2027	131,147.54 EUR	9
30.05.2028	131,147.54 EUR	10
30.11.2028	131,147.54 EUR	11
30.05.2029	131,147.54 EUR	12
30.11.2029	131,147.54 EUR	13
30.05.2030	131,147.54 EUR	14
30.11.2030	131,147.54 EUR	15
30.05.2031	131,147.54 EUR	16
30.11.2031	131,147.54 EUR	17
30.05.2032	131,147.54 EUR	18
30.11.2032	131,147.54 EUR	19
30.05.2033	131,147.54 EUR	20
30.11.2033	131,147.54 EUR	21
30.05.2034	131,147.54 EUR	22
30.11.2034	131,147.54 EUR	23
30.05.2035	131,147.54 EUR	24
30.11.2035	131,147.54 EUR	25
30.05.2036	131,147.54 EUR	26
30.11.2036	131,147.54 EUR	27
30.05.2037	131,147.54 EUR	28
30.11.2037	131,147.54 EUR	29
30.05.2038	131,147.54 EUR	30
30.11.2038	131,147.54 EUR	31
30.05.2039	131,147.54 EUR	32
30.11.2039	131,147.54 EUR	33
30.05.2040	131,147.54 EUR	34
30.11.2040	131,147.54 EUR	35

Data e pagesës	Shuma e kështit për tu shlyer Nr.	
30.05.2041	131,147.54 EUR	36
30.11.2041	131,147.54 EUR	37
30.05.2042	131,147.54 EUR	38
30.11.2042	131,147.54 EUR	39
30.05.2043	131,147.54 EUR	40
30.11.2043	131,147.54 EUR	41
30.05.2044	131,147.54 EUR	42
30.11.2044	131,147.54 EUR	43
30.05.2045	131,147.54 EUR	44
30.11.2045	131,147.54 EUR	45
30.05.2046	131,147.54 EUR	46
30.11.2046	131,147.54 EUR	47
30.05.2047	131,147.54 EUR	48
30.11.2047	131,147.54 EUR	49
30.05.2048	131,147.54 EUR	50
30.11.2048	131,147.54 EUR	51
30.05.2049	131,147.54 EUR	52
30.11.2049	131,147.54 EUR	53
30.05.2050	131,147.54 EUR	54
30.11.2050	131,147.54 EUR	55
30.05.2051	131,147.54 EUR	56
30.11.2051	131,147.54 EUR	57
30.05.2052	131,147.54 EUR	58
30.11.2052	131,147.54 EUR	59
30.05.2053	131,147.54 EUR	60
30.11.2053	131,147.60 EUR	61

- 3.8 *Mospagimi i interesit.*Nëse shlyerjete kësteve nuk kryhen sipas nenit të mësipërm dhe në rastin e ekzekutimit të letrave me vlerë nga KfW-ja, Huadhënësi do të ketë të drejtën për të rritur normën e interesit në pagesat e vonuara me normën bazë plus 3% p.a. për periudhën që fillon me datën e duhur siç thuhet në nenin 7.5 a) dhe b) dhe përfundon në datën në të cilën shlyerjet e tilla janë kredituar në llogarinë e KfW.
- 3.9 *Kompensimi i Mos-pranimit.* Nëse Huamarrësi heq dorë nga disbursimi i një shume nga Pjesa I dhe II e Huasë për të cilën norma e interesit tashmë është përcaktuar, ose nëse një e tillë shuma e kredisë nuk është disbursuar fare ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.4 të Marrëveshjes për Hua dhe Financim për arsye të tjera për të cilat Huadhënësi nuk mund të mbahet përgjegjës, Huamarrësi menjëherë do t'i paguajë Huadhënësit sipas kërkesës shumë e tillë sa është e nevojshme për të kompensuar Huadhënësin për ndonjë humbje, shpenzimet apo kostot e shkaktuara nga Huadhënësi, si rezultat i mospranimit të shumës së Huasë respektive. Huadhënësi do të llogarisë kompensimin e mos-pranimit dhe t'ia komunikojë atë Huamarrësit.
- 3.10 Tarifa e zotimit, interesi dhe ndonjë tarifë tjetër shtesë në pagesat e vonuara në përputhje me nenin 3.6 dhe 3.7 do të llogaritet mbi bazën e një vit 360-ditor dhe muaji 30-ditorë.
- 3.12 Huamarrësi do të paguajë të gjitha pagesat në euro në llogarinë e Huadhënësit në Bankën Qendrore.
- 3.12 *Parapagimi.* Këto në vijim do të zbatohen për parapagimet:
- a) *E drejta e parapagimit të Pjesës I.* Huamarrësi mund të paguajë Pjesën I në tërësi ose pjesërisht në çdo kohë para datës së caktuar së parashikuar Pjesa II u paguhet paraprakisht në mënyrë të plotë ose të paguhet në të njëjtën datë, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje .
 - b) *E drejta e parapagimit të Pjesës II.* Huamarrësi mund të paguajë pjesën II të Huasë në mënyrë të plotë ose në pjesë, por të paktën në shumën e një kësti të shlyerjes si në Klauzolën 3.6 paraprakisht maturitetit kundrejt pagesës së një tarife të parapagimit si në Klauzolën 6.6 f).
 - c) *Njoftimi.* Një parapagim i shumës së Huasë në pajtim me Klauzolën 6.6 b) dhe c) është subjekt i njoftimit të parapagimit nga ana e Huamarrësit tek Huadhënësi jo më vonë se ditën e pesëmbëdhjetë bankare para datës së synuar të parapagimit. Njoftimi i tillë është i pakthyeshëm; ajo duhet të specifikoj datën në të cilën parapagimi do të bëhet, shuma për t'u parapaguar, dhe kjo detyron Huamarrësin t'i paguajë Huadhënësit shumën e deklaruar në datën e deklaruar.
 - d) *Shumat e pagueshme.* Së bashku me parapagimin, Huamarrësi po ashtu do të paguajë këto shuma:
 - aa) çfarëdo tarifë parapagimi e akumuluar si rezultat i parapagimit të shumave të Pjesës I të Huasë; dhe
 - bb) i gjithë interesi i akumuluar në shumën e parapaguar të Huasë deri ne datën e parapagimit.
 - e) *Kompensimi i parapagimit.* Nëse Huamarrësi e shlyen një shumë të Pjesës I ose II të Huasë para kohës së caktuar, Huamarrësi do ti paguajë Huadhënësit një tarifë për parapagim për këtë shlyerje të parakohshme. Tarifa e parapagimit do të llogaritet në bazë të dallimit ndërmjet (i) interesit të cilin Huadhënësi ka mundur ta

ngarkonte për një shumë sipas Pjesës I dhe II të Huasë deri në fund të orarit të mbetur të maturitetit që aplikohet për Huamarrësin nëse Huamarrësi nuk ka shlyer shumën koresponduese të Huasë, dhe (ii) interesin të cilin Huadhënësi mund ta fitojë duke ri-investuar shumën koresponduese të Huasë në konsideratë të shlyerjeve të dakorduara e të zbatuara deri në fund të orarit të mbetur të maturitetit, për të cilën dallimi do të zbritet në bazë të lakores së interesit për ri-investime. Huadhënësi do ta përcaktoj shumën e kompensimit për parapagim dhe do t'ia komunikoj atë Huamarrësit.

f) *Kompensimi*. Klauzola 6.4 (*Shumat e pa disbursuara të huasë*) e Marrëveshjes së Huasë dhe Financimit do të aplikohen mutatis mutandis për kompensimin e parapagimit të shumave të Huasë.

- 3.13 *Orari i rishikuar i shlyerjes*: Në rast të aplikimit të Klauzolës 6.4 (*Shumat e pa disbursuara të huasë*), Klauzola 6.5 (*Disbursimi pas fillimit të shlyerjes*) ose Klauzola 6.6 (*Parapagimi*), nga Marrëveshja e huasë dhe financimit vlen, Huadhënësi do t'i dërgojë Huamarrësit një orar të rishikuar të shlyerjes i cili do të bëhet një pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë oraret e shlyerjes të zbatueshme deri në rast të tillë.

Neni 4 Kostot dhe Tarifat Publike

- 4.1 *Nuk ka zbritje ose ndalesa*. Huamarrësi do të kryej të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa ndonjë zbritje për taksa, pagesa tjera publike ose edhe shpenzime tjera. Në rast se Huamarrësi është i obliguar me ligj, ose për arsye tjera të ndërmer zbritje ose ndalesa nga pagesat, pagesat e bëra nga Huamarrësi do të rriten për atë shumë në mënyrë që Huadhënësi të pranojë në shumë të plotë pagesën e parashikuar me Marrëveshje pas zbritjes së taksave dhe pagesave tjera.
- 4.2 *Shpenzimet*. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet që dalin në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e Huasë, në veçanti remitanca dhe kostot e transferimit (duke përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që dalin në lidhje me mirëmbajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe të gjitha dokumentet e tjera që lidhen me këtë Marrëveshje si dhe të të gjitha të drejtave që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.
- 4.3 *Taksat dhe tarifat e tjera*. Huamarrësi do të bartë të gjitha taksat dhe tarifat e tjera publike që gjenerohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë që kanë të bëjnë me lidhjen dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse ndonjë prej këtyre taksave apo tarifave gjenerohen brenda Republikës Federale të Gjermanisë, Huamarrësi do t'i paguajë ato vetëm deri në shumën e gjeneruar si rezultat i iniciativës së Huamarrësit. Nëse KfW parajep taksa dhe tarifa të tilla, Huamarrësi me kërkesë të KfW-së do të transferoj ato pa vonesë në konton e KfW-së siç specifikohet në Klauzolën 7.3. Klauzola 7 aplikon mutatis mutandis.

Neni 5 Detyrimet e Veçanta

5.1 Huamarrësi do të:

- a) sigurojë financimin e plotë të Projektit dhe sipas kërkesës, të ofroj Huadhënësit dëshmi që tregojnë se obligimet që nuk janë paguar nga Huaja janë mbuluar dhe
- b) me pëlqimin e tyre menjëherë të informojë Huadhënësin (i) për ndodhitë apo ndodhitë e mundshme të ndonjë Rasti të Mospagimit dhe (ii) për ndonjë rrethanë që do të pengoj apo seriozisht rrezikoj implementimin, operimin dhe qëllimin e Projektit.

- 5.2 *Pajtueshmëria*. Huamarrësi do të sigurojë se personave të cilëve u besohet përgatitja dhe implementimi i Projektit, dhënia e çfarëdo kontrate për mallra dhe shërbime që duhet financuar, dhe duke kërkuar shumat e huas të mos kërkoj, pranoj, bëjë, jap, premtoj ose pranoj premtime për pagesa joligjore ose përparësive të tjera në lidhje me këto aktivitete.
- 5.3 *Transporti i mallrave*. Dispozitat e caktuara në Marrëveshjen e Qeverisë, të cilat janë të njohura për Huamarrësin do të vlejnjë për transportin e mallrave që do të financohen nga Huaja dhe Kontributi Financiar.

Neni 6 **Arsyet për Anulimin e Huas**

- 6.1 *NëRastet e Mospagimit*. Huadhënësi mund të ushtroj të drejtat e përcaktuara me Nenin 6.2 (*Pasojat ligjore në një Rast të Mospagimit*) nëse ndodh një rast i cili paraqet arsye materiale. Në veçanti, ngjarjet e mëposhtme paraqesin arsye materiale:
- a) Huamarrësi dështon të kryej obligimin e pagesës ndaj Huadhënësit në datën e caktuar;
 - b) obligimet me këtë Marrëveshje ose me marrëveshje të veçantë që i përkasin kësaj Marrëveshjeje janë shkelur nga Huamarrësi;
 - c) Huamarrësi nuk është në gjendje të tregojë se shumat e Huas janë përdorur për qëllimet e përcaktuara;
 - d) Kjo marrëveshje apo çfarëdo marrëveshje e lidhur ndaras me këtë Marrëveshje ka pushuar të jetë obliguese pjesërisht apo tërësisht për Huamarrësin ose nuk është më e zbatueshme ndaj Huamarrësit;
 - e) çdo deklaratë, konfirmim, informatë apo përfaqësim ose garanci e cila sipas opinionit të Huadhënësit është thelbësore për dhënien dhe mirëmbajtjen e Huas del te jetë e pasaktë, e keqpërdorur apo jo e plotë;
 - f) Sigurimi për Kreditin e Eksportit për kërkesat e Huadhënësit sipas Pjesës I dhe II të Huas nuk është e fuqizuar dhe efektive pa ndonjë kufizim;
 - g) vlerësuar arsyeshëm nga Huadhënësi, pasuritë, situatat financiare apo fitimet e Huamarrësit janë përkeqësuar apo kanë ndodhur në rrethana tjera të jashtëzakonshme të cilat e vonojnë apo përjashtojnë përmbushjen e obligimeve me këtë Marrëveshje;
 - h) ka keqësim të theksuar të vlerës së Sigurimit ose Sigurimi është ose bëhet i pavlefshëm apo i pazbatueshëm, dhe huamarrësi dështon të ofrojë sigurim të vlefshëm apo zëvendësim ekonomikisht ekuivalent brenda katërmbëdhjetë ditëve nga koha kur është kuptuar ose koha kur është dashur të kuptohet për këtë ngjarje.
- 6.2 *Pasojat Ligjore të një Ngjarjeje të Mospagesës*. Nëse njëra nga ngjarjet e përcaktuara në Klauzolën 6.1 është paraqitur dhe nuk është zgjedhur në një periudhë brenda pesë ditëve (rasti i Klauzolës 6.1. a) ose në rastet tjera të specifikuar në Klauzolën 6.1, nuk është zgjedhur në periudhën e përcaktuar nga Huadhënësi, që nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, Huadhënësi mund të anulohet huan në tërësi ose pjesërisht me pasojë që
- a) Obligimet e veta për huan anulohen, dhe

- b) Huadhënësi mund të kërkojë shlyerjen e tërësishme ose pjesëshme të shumës së mbetur të huas me interesin e mbetur dhe çfarëdo shume tjetër të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, me Klausolën 3.8 (*Mospagimi i Interesit*) dhe 7.6 (*Kompensimi Paushall*) të Marrëveshjes së Huas dhe Financimit të aplikueshëm për shumat e përshpejtuara mutatis mutandis.
- 6.3 *Kompensimi për dëmtimet.* Në rast se Huaja anulohet tërësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë kompensimin e mos-pranimit në pajtim me Klausolën 3.10 (*Kompensimi mos-pranues*) dhe/ose kompensimin e parapagimit në pajtim me Klausolën 6.5 e) (*Kompensimi i Parapagimit*).

Neni 7 Zbatimi i Projektit

- 7.1 Projekti do të implementohet nga Huamarrësi. Të gjitha vendimet kyçe lidhur me zbatimin e projektit do të arrihen me konsensus midis KFW-së dhe Huamarrësit , ndërsa Huadhënësi do të jetë i informuar në përputhje me rrethanat .
- 7.2 Huamarrësi dhe huadhënësi bien dakord për të marrë përsipër detyrimet e mëposhtme, të cilat burojnë nga Marrëveshja e Financimit dhe Huadhënjes:
- a. Huamarrësi do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Projektin në përputhje me praktikën e shëndosha financiare dhe inxhinierike dhe kryesisht në përputhje me konceptimin e projektit rënë dakord në mes të Huadhënësit , Huamarrësi dhe KFW-së ;
- b . Huamarrësi do të mbajë libra dhe regjistrime ku tregohen të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe në mënyrë të qartë të identifikoj mallrat dhe shërbimet të financuara nga Huaja; shënimet e tilla do të jenë në dispozicion të Huamarrësit sipas kërkesës;
- c . Huamarrësi do të mundësojë përfaqësuesit e Huadhënësit në çdo kohë të inspektoj , me njoftim të arsyeshëm, librat dhe regjistrimet, si dhe çdo dhe të gjitha dokumentet tjera relevante për zbatimin e Projektit , dhe për të vizituar projektin;
- e. Huamarrësi dhe Huadhënësi duhet menjëherë të njoftojn njëri tjetrin me ndonjë apo të gjitha rrethanat që pengojn ose rrezikojn seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit;
- f . Huamarrësi dhe Huadhënësi duhet mundësisht pas gjashtë muajsh , por jo më vonë se nëntë muaj pas mbylljes së çdo viti financiar , të sigurojnë njëri-tjetrit qasje në raportet e tyre vjetore për çdo vit , së bashku me bilancin përkatës dhe pasqyrën e të ardhurave të përgatitura në përputhje me parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit ;

Neni 8 Dispozitat e Ndryshme

- 8.1 Ndryshimet dhe / ose shtesat e kësaj marrëveshjeje dhe njoftimet dhe deklaratat e dorëzuara nga Huadhënësi dhe Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë e tillë duhet të ketë qenë pranuar pasi ajo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës korresponduese ose në adresën tjetër të palës korresponduese siç është njoftuar pala tjetër:

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT

Rr . Ilaz Kodra , pn , 10000 Prishtinë , Republika e Kosovës

Fax: + 381 (0) 38 500 201

Ministria e Financave

10000 Prishtinë , Republika e Kosovës

Ndërtesa e re e Qeverisë, kati XI

Fax : + 381 38 212 362

Tel : +381 (38) 101 200-34

- 8.2 Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të paprekur nga kjo. Çdo boshllëk që rezultonë nga atje do të plotësohet nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 8.3 Llogaritjet dhe Pagesat në Përgjithësi do të kryhen në përputhje me nenin 7 të Marrëveshjes së Huasë dhe të Financimit.
- 8.4 Kjo Marrëveshje e Nën-Huazimit është ligjërisht e pavarur nga kontratat për mallra dhe shërbime. Huamarrësi nuk mund, në kryerjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje të Nën-Huazimit, të parashtoj detyrimet që rrjedhin nga ose në lidhje me Kontratat për mallra dhe shërbime.
- 8.5 Huamarrësi dhe huadhënësi nuk mund të caktojë ose transferojë, zotoj ose hipotekoj ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje , pa miratimin me shkrim nga pala tjetër .
- 8.6 Hyrja në fuqi :
Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.
- 8.7. Gjuha

Kjo Marrëveshje do të ekzekutohet dhe interpretohet në gjuhën Angleze dhe Shqipe dhe komunikimet ose njoftimet e bëra nën këë Marrëveshjeje do të bëhen në gjuhën Angleze dhe Shqipe.
- 8.8 Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të qeveriset nga ligjet e Republikës së Kosovës. Vendi i performancës do të jetë Prishtina / Kosova.
- 8.9 Në rast se ndodh ndonjë detyrim financiare shtesë që nuk është parashikuar në këtë marrëveshje dhe që mund të lind nga dispozitat e Marrëveshjes së Huasë dhe Financimit të nënshkruar në mes MF-së , KfW-së, dhe KOSTT-it të njëjtat detyrime do ti kalojnë Huamarrësit , në rastet kur këto detyrime i atribuohen qartë Huamarrësit .

8.10 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- a. Nëse ndodh ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit në rrjedhën e implementimit të kësaj Marrëveshjeje për Nën-huazim, kjo së pari duhet të zgjidhet miqësisht. Nëse nuk mund të arrihet marrëveshja me anë të tillë miqësore, ç'do palë mund të angazhohet në procedurën e arbitrazhit , në pajtim me Marrëveshjen e Arbitrazhit e lidhur në mes të KfW-së dhe huadhënësit nën Marrëveshjen e Huasë dhe të Financimit . Në këtë rast, marrëveshja do të zbatohet mutatis mutandis.
- b . Paraqitja për arbitrazh është një paraqitje e vlefshme dhe vendimet e arbitrazhit janë të zbatueshme sipas ligjeve të Republikës së Kosovës.
- c . Huadhënësi dhe Huamarrësi rezervojn të drejtën për të filluar ndonjë veprim ligjor apo procedural që dalin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje në Gjykatën kompetente në Republikën e Kosovës në Prishtinë. Huadhënësi dhe Huamarrësi në mënyrë të përvokueshme dorëzojnë në juridiksionin e kësaj gjykate.

Ekzekutuar më _____ 2013.

HUADHËNËSI

HUAMARRËSI

Besim Beqaj

Naim Bejtullahu

Minister

Kryeshef Ekzekutiv

Ministria e Financave

KOSTT